



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
KOMUNËS SË DRAGASHIT PËR VITIN 2019**

Prishtinë, gusht 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Dragashit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Ariana Berisha-Rexhëbeqaj udhëheqëse e ekipit, Hysen Boqolli dhe Arian Zenelaj anëtarë, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Luljeta Morina.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinion i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	31
Shtojca II: Letër konfirmimi.....	34

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Dragashit për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore janë përgatitur sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik (SNKSP).

Në vitin 2019 Komuna kishte realizuar 81% të buxhetit final. Në kontekstin e sistemit financiar, kontrollet janë të vendosura, megjithatë, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve dhe të hyrave kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Disa dobësi janë identifikuar në menaxhimin e të hyrave, menaxhimin e personelit, të shpenzimeve, menaxhimin e pasurive si dhe rritje të vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme.

Komuna edhe pse kishte ndjekur një proces formal për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për zbatimin e tyre, mangësitë e njëjta janë duke u përsëritur në disa fusha. Zbatimi i rekomandimeve të auditimit ende mbetet sfidë për Komunën e Dragashit. Nga 18 rekomandimet e dhëna në raportin e vitit të kaluar, shtatë rekomandime ishin zbatuar, një ishte zbatuar pjesërisht, tre nuk ishin zbatuar dhe shtatë ishin mbyllur.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. ZKA vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Dragashit, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Komunës së Dragashit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës së Dragashit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në vitin 2019 Komuna kishte realizuar 81% të buxhetit final. Në kontekstin e sistemit financiar, kontrollet janë të vendosura, megjithatë, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve dhe të hyrave kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Dobësi janë identifikuar në menaxhimin e të hyrave, menaxhimin e personelit, të shpenzimeve, menaxhimin e pasurive si dhe rritje të vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ²	2019 Realizimi	2019 Realizimi %	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	8,404,652	9,096,167	7,382,222	81%	7,591,432	6,731,818
Granti i Qeverisë - Buxheti	7,811,174	7,811,174	7,039,851	90%	7,215,850	6,341,807
Huamarrja	92,661	22,414	14,041	63%	69,961	14,425
Të bartura nga viti paraprak ³ -	0	741,233	204,378	28%	158,748	82,193
Të hyrat vetjake ⁴	500,817	500,817	123,952	25%	146,873	223,093
Donacionet e brendshme	0	7,500	0	0%	0	0
Donacionet e jashtme	0	13,029	0	0%	0	70,300

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 691,515€. Kjo rritje është rezultat i bartjes së të hyrave nga vitet paraprake 741,234€, dhe bartjes së donacioneve të brendshme dhe të jashtme në vlerë prej 20,528€ nga viti 2018. Ndërsa, sa u përket Financimeve nga huamarrja për vitin 2019

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

me Qarkore Buxhetore komuna nga Ministria e Financave (MF) është njoftuar se për vitin 2019 do të ketë shumën 92,661€, ndërsa deri në fund të vitit 2019 janë alokuar vetëm vlera prej 22,414€, kjo si rezultat vendimeve nga MF në bashkëpunim me Ministrin e Arsimit dhe të Shëndetësisë. Nga Drejtoria e Arsimit janë shpenzuar për vitin 2019 në vlerë prej 14,041€, prej tyre 6,529€ për mallra dhe shërbime dhe 7,511€ për investime kapitale, ndërsa pjesa e mbetur prej 8,373€ për shkak të mosmarrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe asaj të Financave, alokimi i mjeteve është bërë shumë vonë dhe shkollat nuk kanë mundur t'i shfrytëzojnë.

Komuna e Dragashit në vitin 2019 kishte shpenzuar 81% të buxhetit final, në raport me vitin paraprak kemi një ulje të realizimit për 7%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2019 Realizimi	2019 Realizimi %	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	8,404,652	9,096,167	7,382,222	81%	7,591,432	6,731,818
Pagat dhe Mëditjet	4,568,960	4,569,970	4,458,302	98%	4,469,699	4,252,501
Mallrat dhe Shërbimet	868,908	880,430	773,014	88%	814,867	569,989
Shërbimet komunale	130,000	130,000	120,305	93%	105,151	108,277
Subvencionet dhe Transferet	50,000	180,000	167,050	93%	44,020	34,445
Investimet Kapitale	2,786,784	3,335,767	1,863,551	56%	2,157,695	1,766,606

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti fillestar me buxhetin final te kategoritë: paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale nuk kishte ndonjë ndryshim të madh. Për këto kategori komuna kishte arritur të realizoj në një vlerë të konsiderueshme buxhetin në dispozicion;
- Rritja e buxhetit final për 130,000€, krahasuar me buxhetin fillestar për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve ishte si rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga viti paraprak; dhe
- Në kategorinë e investimeve kapitale buxheti final ishte rritur për 548,983€. Pjesa më e madhe e realizimit të buxhetit apo 60% të kësaj kategorie ishte shpenzuar në fund vit, përderisa realizimi i kësaj kategorie ishte vetëm 56%. Kjo kishte ndodhur si rezultat i vonesave në iniciimin e procedurave të prokurimit si dhe nënshkrimin e kontratave, mungesës së paraqitjes (aplikimit) të OE-ve dhe pronës adekuate për realizimin e projekteve, procedurat e zgjatura të ankesave në OSHP si dhe për shkak të çmimeve të ulëta të ofruara në 57 projekte.

Çështja A1- Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Në dy raste komuna kishte bërë klasifikimin e shpenzimeve në kode të gabuara ku nga kategoria e investimeve kapitale kodi ekonomik 31230 (ndërtimi i rrugëve lokale) kishte paguar për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve përkatësisht 14032 (mirëmbajtja e auto rrugëve lokale), në vlerë prej 65,975€.

Shkaku i keq-klasifikimit ishte mungesa e buxhetit në kategoritë përkatëse.

Ndikimi Pagesat e realizuara nga kategoria jo-adekuate, rezultojnë me prezantimin e gabuara të shpenzimeve në Pasqyrat Financiare. Raportimi jo i drejtë i të dhënave për klasifikimin e shpenzimeve, çorienton shfrytëzuesit e këtyre informatave të prezantuar gabimisht në PFV apo ndikon në vendimmarrjen e menaxhmentit.

Rekomandimi A1 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkesat të planifikohen dhe kategorizohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e komunës, duhet të bëhet ridestnimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për buxhetimin e kërkesave në kategoritë përkatëse ekonomike dhe fuqizimin e kontrollit për pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejtë të shpenzimeve publike në PFV.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Dragashit në 2019 ishin në vlerë 353,507€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat	500,817	500,817	353,507	71%	349,402	363,709
Totali	500,817	500,817⁵	353,507	71%	349,402	363,709

Të hyrat e realizuara janë 71% sepse në planifikim janë përfshirë edhe të hyra nga dënimet e policisë, gjobat e gjykatave dhe agjencisë të pyjeve, kurse te pranimet nuk është paraqitura ky realizim në vlerë 66,107€, (ku realizimi do të ishte 84%).

Çështja A2 - Parregullsi në dhënien me qira të pronave komunale

Gjetja

Sipas nenit 1 pika 1 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, cek "Ky ligj ka për qëllim të siguroj shfrytëzimin efektiv të pronës së paluajtshme të komunës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, rritjen e vlerës së pronës së paluajtshme të komunës dhe përmbushjes së interesit të përgjithshëm kurse neni 8 pika 1 "Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bëhet përmes procedurave të 1.1 ankandit publik; 1.2 shprehjes së interesit; dhe 1.3 negociatave të kryetarit të komunës".

Në regjistrin e Komunës së Dragashit figurojnë 104 prona/toka të cilat janë në shfrytëzim. Prej tyre një është me kontratë valide, 26 prona janë me kontrata para viteve 2000⁶ dhe 77 prona tjera shfrytëzohen me kontrata të skaduara, që nga viti 2002 deri 2017. Edhe përkundër shkresave, njoftimeve të kohëpaskohshme dhe pajtimit të shfrytëzuesve për pagesën e borxhit, Komuna nuk ka ripërtërirë kontratat apo nuk ka kontraktime përmes proceduarve. Komuna mund të përballet me vështirësi në mbledhjen e këtyre të hyrave, në mungesë të

⁵ Në planifikim janë përfshirë edhe të hyrat indirekte.

⁶ Sipas dëshmive të komunës këto prona janë dhen në shfrytëzim para viteve 2000, ku janë ndërtuar objekte private ndërsa tokat kanë karakter të pronës komunale ende.

kontratave valide apo bazës ligjore për ngarkesat⁷ e qirasë.

Kjo gjendje ka ndodhur për shkak të neglizhencës së zyrtarëve komunal për vazhdimin/dhënien e kontratave me ankand publik të përcaktuar me ligjin në fuqi.

Ndikimi

Shfrytëzimi i pronave publike, pa kontrata valide mes komunës dhe shfrytëzuesve të pronës komunale mund t'i shkaktoj komunës humbje të konsiderueshme financiare, po ashtu humb mundësinë për të siguruar se prona publike në dispozicion të komunës menaxhohet si duhet. Gjithashtu, shumat e pa inkasuara dëmtojnë edhe rrjedhën e parasë të komunës dhe rrjedhimisht ndikojnë në zvogëlimin e mundësisë së përdorimit të saj në përmbushjen e objektivave ndaj qytetarëve.

Rekomandimi A2 Kryetari i komunës duhet të shtojë kontrollet lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale duke vlerësuar të gjitha kontrata, si dhe duke ndërmarrë masa në arkëtimin e të hyrave të pa inkasuara. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurojë së dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim bëhet sipas kërkesave të ligjit për shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Çështja A3 - Dobësi në procedurat e mbajtjes së ankandit publik

Gjetja

Komuna në vitin 2018 ka filluar procedurën e ankandit publik sipas ligjit që ishte në fuqi Nr. 04/L-144⁸ nenin 8 pika 1, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës neni 8 paragrafi 1 "Për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës afatshkurtër dhe afatgjatë, formohet Komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, cili përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve", dhe në Rregullore QRK nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës Neni 8 "Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik" paragrafi 2.4. Të tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre ditë para mbajtjes së ankandit publik.

Kuvendi Komunal i Dragashit në seancën e dt. 30.01.2018 ka miratuar Vendimin për themelimin e komisionit për vlerësimin e ofertave të pronave të paluajtshme në përbërje prej shtatë⁹ (7) anëtarëve. Njoftimi i ankandit publik është bërë me dt.13.11.2018 deri më 13.12.2018. Pas mbylljes së ankandit publik me

⁷ Në vitin 2019 të gjithë shfrytëzuesve të tokave në pronësi të komunës, iu është dërguar vërejtje për pagesë të qerasë duke përfshirë vlerën e borxhit për secilin duke u bazuar në kontrata paraprake. Prej 312,769€ që kishite ngarkuar komuna me borxh, vetëm 86,919€ kanë arritur të arkëtojnë dhe 225,850€ kanë mbetur borxhe të pa mbledhura.

⁸ Ky ligj është shfuqizuar në muajin Prill të viti 2019, sepse ka hy në fuqi ligji i ri nr.06/L-092.

⁹ (tre (3) anëtar të Kuvendit Komunal, tre (3) nga ekzekutivi i Komunës-Dragash dhe një (1) anëtar nga shoqëria civile.

dt.18.12.2018 njëri nga anëtarët e komisionit për vlerësimin e ofertave ka dhënë dorëheqje. Komisioni ka bërë vlerësimin e ofertave në mungesë të një anëtari me dt.28.12.2018. Zëvendësimi i tij është bërë me dt.31.01.2019, pas vlerësimit të ofertave. Po ashtu, pesë ofertues me çmime më të larta, për pronat Tregu i gjelbër dhe Auto parkingu ishin tërhequr pas hapjes së ofertave. Nga ky ankand kanë rezultuar gjashtë marrëveshje për shfrytëzim të pronave komunale.

Sipas zyrtarëve komunal vlerësimi i ofertave në mungesë të një anëtari ka ndodhur pasi që seanca e Kuvendit Komunal nuk ka mundur të mbledhet më herët se data 31.01.2019 për të zëvendësuar komisionin, ndërsa tërheqja e ofertuesve më të leverdishëm ishte sepse ligji/rregullorja nuk parasheh ndonjë penallti për tërheqjen e kandidatëve.

Ndikimi Vlerësimi i ofertuesve në mungesë të anëtarëve të komisionit siç e parasheh ligji humb besimin e ofertuesve potencial në një proces të drejtë të ankandit publik, po ashtu tërheqja e ofertuesve pas hapjes së ankandit shton rrezikun e mos arritjes së vlerës për para.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj që procesi i vlerësimit të ankandëve publike bëhet nga përbërja e plotë e komisionit për vlerësimin e ofertave të pronave të paluajtshme, si dhe me të krijoj kushte që ofertuesit potencial të mos tërhiqen prej konkurrimit.

Çështja A4 - Mangësi në inkasimin e të hyrave për Leje Mjedisore Komunale (LMK)

Gjetja Sipas Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.01/2017-“Për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale” neni 10- Shqyrtimi i raportit për LMK cek: “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e raportit për LMK, Drejtori i Drejtorisë përkatëse Komunale, formon komisionin profesional prej tre anëtarëve, neni 15 pika 1.1 dhe 1.2 përcakton se për tu pajisur me LMK aplikuesi duhet të paguaj tarifën në vlerë prej 50€ për vlerën investive të projektit deri 25,000€ dhe tarifën prej 0.2% të vlerës investive të projektit për projektet mbi 25,000€.

Në dy raste komuna ka lëshuar Leje Mjedisore Komunale (LMK) për 10 vite duke u thirrur në nenin 10 pika 2 përderisa nuk ekzistonte kjo pikë në këtë UA dhe nuk ka aplikuar tarifën. Efekti i mosaplikimit të kësaj tarife ka ndikuar që komuna të inkasoj më pak të hyra në vlerë të përafërt prej 854€¹⁰, nga LMK.

¹⁰ Vlera është përcaktuar vetëm për një tërësi mostër.

Arsyeja e mos aplikimit të këtij Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017, në lidhje me tarifën, përkatësisht taksën për lëshimin e Lejes Mjedisore Komunale sipas Drejtorisë së Urbanizmit është se “UA nuk është i harmonizuar me Rregulloren Komunale për tarifatat dhe gjobat dhe kjo do të zbatohet në Rregulloren e re” që është duke u përgatitur nga komuna.

Ndikimi Mos aplikimi i taksës sipas kërkesave ligjore për LMK dhe mos angazhimi i zyrtarëve kompetent për të reflektuar me kohë ndryshimet ligjore ka ndikuar që të hyrat prej kësaj kategorie të jenë më të ulëta.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të vendos kontrolle duke caktuar zyrtar përgjegjës për përcjelljen e rregullave të nivelit qendror, dhe që të njëjtat të jenë të harmonizuar me rregulloret e brendshme komunale, dhe me kohë të iniciohen plotësim/ndryshimet e rregulloreve komunale duke i përcjellë për miratim tek organet relevante.

Çështja B1- Depozitim i vonuar i parasë në bankë

Gjetja Sipas Nenit 11 të Rregullës Financiare 03/2010, për të hyrat, citohet se: “Paratë e grumbulluara në vlerë deri në 10€ nga arkat e OB-ve në fund të ditës duhet të depozitohen (në llogari bankare zyrtare), total për çdo lloj të të hyrave me faturë përmbledhëse me numrin identifikues UNIREF”. Komuna edhe në këtë vit, paratë e grumbulluara nga të hyrat nëpërmes arkës nuk i ka deponuar në llogarinë bankare me kohë. Paratë e mbledhur prej datës 08.11.2019 deri me dt. 31.12.2019 në vlerë prej 733€, janë deponuar në llogarinë e komunës me dt. 31.12.2019 apo deri 53 ditë vonesë.

Një dukuri e tillë ndodhë për shkak se është e pamundur të bëhet depozitimi i mjeteve në baza ditore, si rezultat i territorit (fshatrave) të hapura të komunës.

Ndikimi Mbajta e parasë në arkë mundëson keq përdorimin e parasë publike. Depozitimi i vonuar i të hyrave në llogarinë zyrtare reflekton edhe në raportimin jo të drejtë të të hyrave sipas periudhës kohore, sepse periudha e pranimit të parasë publike është e më hershme, krahasuar me periudhën e regjistrimit dhe raportimit të këtyre të hyrave.

Rekomandimi B1 Kryetari të siguroj se do të zbatohen kërkesat ligjore për depozitimin në llogari bankare me kohë të të hyrave të mbledhura, nëpërmes arkës nga zyrtarët kompetent.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 4,569,970€, i cili ishte i shpenzuar 98%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 777 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 770. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 48¹¹ të rinj. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 42,378€, si dhe 27 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A5 – Dobësi në procesin e rekrutimit

Gjetja Sipas nenit 6 pika 5 e UA 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, përcaktohet që - Konkursi publik duhet të përsëritet nëse së paku tre kandidatë nuk i plotësojnë kriteret e shpallura me konkurs.

Konkursi i shpallur më dt.18.07.2019 dhe nr.13/439 për mësimdhënës të shkollave të mesme të ulëta (SHFMU), në 24 raste/pozita, për pozitat e njëjta kishte më pak sesa tre kandidatë. Në SHFMU “Ruzhdi Berisha” mësimdhënës i lëndës së matematikës me 10 orë mësim (zëvendësues) dy kandidatë, mësimdhënës i praktikës profesionale të farmacisë më 10 orë mësim një kandidatë, në SHFMU “Shaban Shabani” Plavë një mësimdhënës për mësim klasor (zëvendësues) dy kandidatë, në SHFMU “Shaban Shabani” Ulina Kosavë një mësimdhënës i gjuhës gjermane me 13 orë mësim, një kandidatë, në SHFMU “Restelica” Restelicë për 10 mësimdhënës lëndë të ndryshme nga një kandidatë, në SHFMU “9 Maji” Rapçë, një mësimdhënës për mësim klasor një kandidatë, në SHFMU “Zenuni” Brod për tre mësimdhënës për lëndë mësimore të ndryshme nga një kandidatë dhe në SHFMU “Svetlost” Krushevë për gjashtë mësimdhënës të lëndëve të ndryshme nga një kandidatë.

Po ashtu në 20 raste të punësuarit në gjuhën boshnjake nuk kishin fakultetin përkatës apo fakultet të kryer.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së interesimit të qytetarëve për konkurrim që ka rezultuar në mungesë të konkurrencës së paraparë, po ashtu konkursi për punonjësit në gjuhën boshnjake përsëritet çdo vit për arsye se të rekrutuarit nuk kanë përgatitje profesionale të duhur (diplomë apo diplomë të noterizuar).

Ndikimi Pranimi i punonjëseve në mungesë të konkurrencës paraqet parregullsi dhe mund të ndikoj në cilësinë e dobët të shërbimit të mësimdhënies së pranuar.

Rekomandimi A5 Kryetari të ndërmarr veprimet e duhura në vlerësimin e situatës dhe siguroj që punësimi bëhet duke respektuar kriteret e konkursit.

¹¹ Drejtorja e Arsimit dhe Shkencës 36, Drejtorja e Shëndetësisë 4 dhe Administratën komunale 8 punonjës.

Çështja B2 - Mungesa e vërtetimit për kompensimin e shtesës për përvojën e punës

Gjetja Vendimi i Qeverisë nr.06/29 i dt.15.05.2015 në paragrafin 6 kërkon një vendim të vërtetuar nga zyrtarët e autorizuar të personelit për dëshminë e viteve të përvojës së punës.

Në 15 raste në drejtorinë e shëndetësisë dëshmitë për vitet e përvojës së punës nuk ishin të pasqyruara me një vendim të vërtetuar nga zyrtarët e autorizuar të personelit, si bazë për kompensim. Kjo ka ndodhur si pasojë e pakujdesisë të stafit përgjegjës për të kompletuar dosjet.

Ndikimi Pagesat e bëra për shtesën 0.5% në vit për përvojën e punës pa dëshmi përkatëse mund të rezultojë me kompensim jo real.

Rekomandimi B2 Kryetari i komunës përmes menaxherit të personelit duhet të sigurohet se stafi i drejtorisë së shëndetësisë kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 880,430€, prej tyre ishin shpenzuar 773,014€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese tjera, furnizim për zyre, naftë për ngrohje qendrore, dru, mirëmbajtja e shkollave, shpenzime tjera të udhëtimit zyrtar brenda vendit, etj. Kemi testuar 22 mostra për teste substanciale në vlerë 110,683€ si dhe nëntë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A6 - Mos konfiskimi i sigurisë së tenderit

Gjetja Sipas Ligjit për Prokurim Publik nr. 04/L-042 neni 57 paragrafi 1 parasheh "Gjatë një aktiviteti të prokurimit që shpie drejt dhënies së një kontrate me vlerë të mesme ose të madhe, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit që të depozitojnë siguri (garantim) për tender. Siguria e tenderit që është depozituar nga tenderuesi do të konfiskohet, në rast se alineja 1.3 tenderuesit në fjalë i është dhënë kontrata përkatëse në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi pastaj refuzon ose dështon: (i) që të depozitojë çfarëdo sigurie të kërkuar të ekzekutimit që ishte specifikuar në dosjen e tenderit; (ii) që të përmbushë çfarëdo kushti tjetër që ishte specifikuar në dosjen e tenderit, para nënshkrimit të kontratës përkatëse, ose (iii) që të ekzekutojë një kontratë që përputhet me kushtet e specifikuara në dosjen e tenderit.

Në dosjen e tenderit “Furnizim me dru dhe pelet për (24 muaj) lot I” te kërkesat e përshtatshmërisë përveç tjerash ishte kërkuar vërtetimi nga ATK-ja dhe nga Gjykata ekonomike, kurse në pikën IV.3.4 informacionet administrative ishte kërkuar siguria e tenderit në vlerë 3,000€ me vlefshmëri prej 120 ditë (që ishte siguruar nga OE-ja). OE më i lirë që kishte plotësuar kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit, me dt. 22.05.2019 i është kërkuar nga zyra e prokurimit që para shpërblimit me kontratë t’i dorëzoj këto dy vërtetime (dokumente). I njëjti nuk i kishte ofruar këto dy vërtetime, përderisa komuna nuk kishte tërhequr sigurinë e tenderit dhe kishte shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik më të shtrenjtë për 25,680€ sesa oferta e parë me çmim më të ulët.

Shkaku i mos ekzekutimit të sigurisë së tenderit është neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës për t’i ndërmarr veprimet e duhura.

Ndikimi Mos konfiskimi i sigurimit të tenderit, përkundër se kishte ndodhur ngjarje apo rrethanë që kërkonte një gjë të tillë tregon që Komuna nuk i kishte përdorur mekanizmat e caktuar duke dëmtuar buxhetin e saj.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit se aplikohet proces i plotë i procedurave të prokurimit në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi duke ndërmarr veprimet e nevojshme, tërheqjen e sigurisë së tenderit për ofertuesit jo serioz.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere në 2019 ishte 180,000€, prej tyre ishin shpenzuar 167,050€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencione për entitete jopublike, paga për përfituesit individual dhe transfere qeveri tjera. Kemi testuar pesë mostra për teste substanciale në vlerë 72,200€ si dhe katër mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A7 - Mangësi në kërkesat për subvencionimin e OJQ-ve

Gjetja Rregullorja e MF-së Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nenin 10 paragrafin 1.5 parasheh: “Të mos ekzistoj ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit përkatësisht përfaqësuesit/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore” ndërsa në paragrafin 2 për plotësimin e kërkesës së paragrafit 1.5 të nenit 10 kërkohet që: “aplikuesi të nënshkruan dhe dorëzon deklaratën përkatëse”.

- Në thirrjen publike të dt. 07.05.2019 më nr. 2660/01-9824¹² të lëshuar nga zyra e kryetarit të komunës së Dragashit nuk është kërkuar deklarata e konfliktit të interesit që duhej të dorëzohej dhe nënshkruhej nga aplikuesit.

¹² 1. Vlera e mbështetjes financiare nga kjo thirrje ishte 27,000€.

Kjo ka ndodhur si pasoj e mungesës së përvojës paraprake, pasi që rregullorja për dhënie e subvencioneve është aplikuar për herë të parë këtë vit.

- Po ashtu në thirrjen e njëjtë publike (nr. 2660/01-9824) të lëshuar nga zyra e kryetarit të komunës është kërkuar që: Aplikimet pika 2 “të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo qeveritare në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në territorin e komunës së Dragashit”.

OJQ – Klubi i mundjes Hidroterm – Suharekë, është subvencionuar në vlerë 12,000€ për aktivitetin “Organizimi i garave Tradicionale të Pehlivanëve dhe të vrapimit të kuajve” në nivel të Kosovës, po ashtu te i njëjti OJQ në dosjen e tenderit mungonte vërtetimi për kryerjen e obligimeve ndaj ATK-së. Kjo ka ndodhur si pasojë e pakujdesisë së komisionit vlerësues gjatë përzgjedhjes së përfitueseve duke mos marrë për bazë të gjitha kërkesat, dhe për shkak se në komunën e Dragashit nuk ka ndonjë OJQ që është e regjistrua për këtë qëllim apo që zhvillon aktivitet të kësaj natyre brenda territorit të komunës.

Ndikimi

Përzgjedhja e përfitueseve, pa i plotësuar kriteret e vendosura në shpalljen publike ka reflektuar trajtim jo të barabartë të aplikuesve dhe mos përfshirja e kërkesave minimale rrezikon financimin e OJQ-ve që mund të jenë në konflikt interesi me organizatën buxhetore.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të siguroj që më rastin e shpalljes/thirrjes publike të vendosen kriteret dhe që më rastin e përzgjedhjes së përfitueseve të subvencioneve të shpërblehen vetëm ata të cilët i kanë plotësuar të gjitha kërkesat.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,335,767€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 1,863,551€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, ujësjellësit, kanalizimeve, objektet arsimore, fushat sportive etj. Kemi testuar 47 mostra për teste substanciale në vlerë 1,072,465€ si dhe 11 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja C1 - Mungesa e projektit ekzekutiv

Gjetja

Neni 20 pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) kërkon që “Specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten”. Ndërsa, pika 13 “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderi”. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Në katër¹³ nga shtatë mostra të testuara, komuna nuk kishte realizuar hartimin e projektit ekzekutiv edhe pse kishte të kontraktuar kompani për hartimin e tyre. Vlera totale e kontratave në fjalë është 274,536€. Shkaqet e mos hartimit të projektit ishin neglizhenca e zyrtarëve përkatës dhe fakti që procedurat e prokurimit të mos vonohen.

Ndikimi Zhvillimi i procedurave të prokurimit pa projekt ekzekutiv, rrisin rrezikun e realizimit të punëve pa kritere standarde të ndërtimit, vonesa në realizimin e tyre dhe të mos arrijnë cilësinë e duhur.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë që hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet para inicimit të procedurave të prokurimit.

Çështja A8 - Vendosja e kriterëve jo në pajtueshmëri me Ligjin e Prokurimit Publik

Gjetja Sipas nenit 65 paragrafi 4.1 të LPP nr. 04/L-042, - “Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik ...gjatë dy (2) viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent, ose aktualisht është në procedurë: (i) të falimentimit, (ii) të pranimin të urdhrit për likuidim ose përmbyllje të aktivitetëve ose administrimit nga gjykata ose (iii) ndonjë procedurë tjetër të ngjashme sipas ligjit të Kosovës ose ndonjë juridiksioni tjetër”.

Tek kontrata “Ndërtimi i stadiumit dhe sipërfaqeve gjelbëruese në fshatin Kuk, në vlerë prej 35,205€, Komuna nuk kishte vendosur kriterin – Vërtetimin e gjykatës, konform kërkesave të përshtatshmërisë ku përveç tjerash OE duhet të ofroj Vërtetimin e Gjykatës kompetente.

Shkaku i mos vendosjes së një kriteri të tillë ishte neglizhenca në vlerësimin e një kriteri të tillë krahas vlerës së kontratës.

Ndikimi Zhvillimi i procedurave të prokurimit pa një dëshmi përkatëse rrit rrezikun që fituesi i kontratës mund të jetë nën falimentim, apo procedura hetimore sikur edhe parashihet me ligjin përkatës.

Rekomandimi A8 Kryetari duhet të sigurojë që në procedura të prokurimit, kriteret të vendosen sipas kërkesave ligjore duke vërtetuar përshtatshmërinë e operatorëve ekonomik.

¹³ 1. Vazhdimi i kanalizimit në fshatin Rapçë, vlera 32,270€, 2. LOT1 - Ndërtimi i stadiumit dhe sipërfaqeve gjelbëruese në fshatin Kuk. vlera 35,204€, 3. Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatin Bresanë – ri tenderim, vlera 157,840€ dhe 4. Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në fshatin Blaq 49,221€.

Çështja A9 - Shkëputja e kontratës jo në pajtim me rregullat

Udhëzuesi Operativi Prokurimit Publik (UOPP) përkatësisht pika 61.26 cekë “Kur menaxheri i projektit beson se duhet të ndërpritet një kontratë, menaxheri i projektit do të dorëzojë një rekomandim për ndërprerje tek departamenti i Prokurimit”, 61.28 “Asnjë kontratë nuk do të ndërpritet para marrjes së aprovimit nga Departamenti i Prokurimit dhe ZKA i autoritetit kontraktues. Kontrata ndërpritet kur Vendimi për ndërprerje i ZKA dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit bëhet i plotfuqishëm. Vendimi bëhet i plotfuqishëm kur nënshkruhet nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit” dhe 61.29 “Kur ndërpritet një kontratë, Departamenti i Prokurimit do ta informojë Operatorin Ekonomik të përfshirë rreth arsyeve të ndërprerjes dhe do të merr masa të menjëhershme në përputhje me kushtet e Kontratës”.

Nga analiza e listës së kontratave të nënshkruara kemi konstatuar se në 20¹⁴ raste ishin shkëputur kontratat jo në pajtim me kërkesat ligjore. Organi mbikëqyrës në raste të ndryshme kishte bërë ndërprerjen e punimeve (për shkak se OE fituese nuk ishin serioz në përmbushjen e kontratave me kohë, kryerje e të gjitha punëve sipas pozicioneve, proceseve të pa zgjidhura pronësore etj), duke përgatitur raport të pranimit teknik vetëm për punët e pranuar edhe pse kontrata nuk ishte përmbushur në tërësi. Përkundër që zhvillohej komunikim mes organit mbikëqyrës dhe zyrës së prokurimit, kjo e fundit nuk kishte

¹⁴ Titulli i kontratës: Kubëzimi i rrugëve dhe rregullimi I infrastrukturës përcjellëse në fshatin Rapçë, vlera 7,863.90; Ndërtimi I objektit të qendrës së komunitetit në fshatin Restelicë, vlera 65,730.95; Ndërtimi i rrethojës së shkollës në fshatin Restelicë, vlera 9,067.00; LOT2 - Kubëzimi i rrugëve dhe rregullimi i infrastrukturës në fshatin Kukajan, vlera 9,946.41; Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Krushevë, vlera 24,421.75; Kubëzimi i rrugëve dhe rregullimi infrastrukturës përcjellëse në fshatin Zlipotok, vlera 15,082.94; Rekonstruimi i rrugës së asfaltuar dhe kubëzimi i rrugëve në fshatin Kërstec, vlera 24,305.00; LOT1-Kubëzimi i rrugëve dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatin Baçkë, vlera 14,359.38; Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit në fshatin Rapçe, vlera 17,766.00; Ndërtimi i murit dhe oborrit të shkollës në Llopushnik, vlera 48,732.46; Renovimi i përronit, murit mbrojtës dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatin Brod, vlera 37.668.39; LOT1 - Ndërtimi rrethojës së shkollës, drenazhimi dhe infrastrukturës përcjellës në fshatin Kapre, vlera 17,847.56; LOT2 - Ndërtimi i murit mbrojtës - vazhdimi punimeve në fshatin Brrut, vlera 18,954.65; Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatin Bresanë, vlera 157,840.00; Ndërtimi i aneksit të nyjeve sanitare të shkollës fillore “Ilmi Bahtijari” në fshatin Blaq, vlera 18,258.50; LOT2 - Ndërtimi i stadiumit të shkollës në fshatin Brod, vlera 21,450.50; LOT2 - Rregullimi i nyjeve sanitare dhe renovimi i shkollës së mesme “ Ruzhdi Berisha” në Dragash, vlera 27,698.18; LOT1 - Ndërtimi i mureve me infrastrukturës përcjellëse në fshatin Zym, vlera 16,342.01; Kubëzimi i rrugëve dhe infrastrukturës tjetër në Dragash, vlera 49,910.95; Ndërtimi i amfiteatrit dhe objektit përcjellës në fshatin Bellobrad, vlera 42,839.01.

aprovuar ndërprerjen e këtyre kontratave dhe nuk kishte aprovim as nga ZKA.

Shkaku i një dukurie të tillë ishte neglizhenca e stafit si dhe niveli jo i duhur i bashkëpunimit në mes departamenteve.

Ndikimi

Ndërprerja e kontratave aktive pa marrë aprovimin ligjor, mundëson që këto kontrata të mbesin aktive edhe më tutje, të njëjtat rrisin rrezikun që komuna të ballafaqohet me raste gjyqësorë dhe të paguaj dëmshpërblim si pasojë e prerjes së njëanshme të punimeve dhe mos përmbushja e vlerës së kontratës. Gjithashtu një dukuri e tillë rrit rrezikun e keqpërdorimit të parasë publike pasi që nuk zbatohen kriteret e përcaktuara sipas kontratës dhe Ligjit të Prokurimit Publik.

Rekomandimi A9 Kryetari i Komunës duhet të sigurohet që të ndalohet praktika e ndërprerjes së kontratave pa përfillë procedurat dhe kriteret ligjore. Gjithashtu duhet siguruar nivelin e duhur të komunikimit mes departamenteve me qëllim të përmbushjes së objektivave të komunës krahas respektimit të ligjeve.

2.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B3 – Shmangie e procedurave të hapura të prokurimit

Gjetja

Pika 54.1 i Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik përcakton që “Autoriteti kontraktues mund ta përdor procedurën me vlerë minimale për çdo kontratë publike vlera e përlogaritur e të cilës është më pak se 1,000€. Me dhënien e porosive për blerje në lidhje me prokurimin me vlerë minimale, Autoriteti kontraktues do të sigurojë një konkurrin efektiv, transparencë dhe efektivitet të lartë të përdorimit të fondeve publike. Kontratat me vlera minimale që zhvillohen në Institucionet arsimore, person i autorizuar të nënshkruaj një kontratë është Drejtori i Institucionit Arsimor” dhe 54.2 “Në llogaritjen e vlerës së kontratës për përdorimin e procedurës së vlerës minimale, autoriteti kontraktues do t’i marrë parasysh vetëm një grup të mallrave, shërbimeve apo punëve të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen së bashku dhe të cilat nuk duhet të ndahen me qëllim të përdorimit të një procedure të tillë”.

Nga raporti i kontratave të nënshkruara për vitin 2019 komuna kishte nënshkruar 95 kontrata përmes procedurës me vlerë minimale. Gjatë auditimit kemi vërejtur se ka ndarje të tenderëve, ku për furnizime dhe shërbime të natyrës

së njëjtë janë zhvilluar një¹⁵ numër i procedurave duke anashkaluar procedurat e hapura të tenderimit. Shkaqet e realizimit të procedurave të ndara të prokurimit është mungesë e komunikimit të njërive kërkuese dhe prokurimit gjatë përgatitjes së planit për prokurim.

Ndikimi Praktika e tillë shton rrezikun e mos arritjes së vlerës për para dhe dëmtojnë transparencën, eliminojnë konkurrencën dhe vejnë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve dhe produkteve të pranuar.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj që bëhet një planifikim i hollësishëm dhe njësitë kërkuese duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 37,001,456€, pasurive jokapitale është 321,263€, si dhe e stoqeve 2,716€. Kemi testuar 47 mostra për teste substanciale në vlerë 670,210€, si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja C2 - Mangësi në evidentimin e pasurisë

Gjetja Sipas Rregullores 02/2013 “Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale (vlera individuale mbi 1,000€ dhe afat të përdorimit më shumë se një vit), pasuritë jo kapitale (vlera individuale më e vogël se 1,000€ dhe afat të përdorimit më shumë se një vit) dhe stoqet.

- Regjistri i e-pasurisë nuk ishte i plotë për arsye se blerjet nga sektori i QKMF-së, Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Arsimit edhe pse mbahen në regjistra të brendshëm, të njëjtat nuk regjistrohen në softuerin e e-pasurisë dhe nuk kanë vlerë të stokut. Gjithashtu te pasuritë mbi 1,000€ konstatuam se dy pagesa nuk ishin regjistruar në SIMFK, ku vlera totale e tyre ishte 5,672€. Përkundër shtimit të kapaciteteve njerëzore, mungesa e vendosjes së komunikimit të nevojshëm brenda departamenteve dhe neglizhenca e stafit ka bërë që edhe për vitin 2019 sistemi i e-pasurisë, dhe

¹⁵ 1. Furnizim me material higjenik tri kontrata në vlerë 2,498€; Mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe administratës nëntë kontrata në vlerë 7,946€; Furnizim me material për mirëmbajtje të shkollave shtatë kontrata në vlerë 5,212€; Furnizim me material didaktik për shkolla katër kontrata në vlerë 2,828€; dhe Furnizim me pajisje kompjuterike tri kontrata në vlerë 2,889€.

pasuria mbi 1,000€ në PVF të mos jetë e plotë.

Ndikimi Mangësitë në regjistrimin e plotë të pasurisë duke mos përfshirë të gjitha blerjet, vështirësojnë identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën, prejardhjen dhe pronësinë e tyre. Kjo rezulton edhe me nënvlerësim të pasurive të prezantuara dhe shpalosura në PFV.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të siguroj se kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, përmes sistemit e-pasuria të evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme (me vlera nën 1,000€) për të gjitha dikasteret komunale.

2.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme (LLA) në vlerë prej 1,927,946€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë, taksa komunale në biznese dhe shfrytëzimi i pronës komunale.

Çështja B4 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Komuna nuk ka një plan për inkasimin e llogarive të arkëtueshme nga debitorët e saj. Si pasojë, të arkëtueshmet vazhdimisht po rriten duke shkaktuar vështirësi në inkasimin e tyre. Në vitin 2019 kemi një rritje prej 95,666€ apo 6% krahasuar me vitin paraprak (1,832,279€).

Shkaku i një dukurie të tillë është mungesa e mekanizmave adekuatë nga ana e komunës për t'i arkëtuar këto të hyra dhe kompetenca jo e mjaftueshme e stafit përgjegjës.

Ndikimi Mungesa e mekanizmave dhe efikasitetit për inkasim të borxheve nga debitorët mund të shkaktoj probleme në përmbushjen e planit të shpenzimeve, ndërsa vjetërsia e tyre zvogëlon gjithnjë e më shumë gjasat që borxhet të inkasohen.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2019, ishte 11,361€¹⁶. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

2.4.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019, ishte 237,026€

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Detyrimet kontraktuale të raportuara nga ana e Komunës në fund të vitit 2019 janë në vlerë prej 159,388€¹⁷

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm (NJAB) operon vetëm me një anëtar – Drejtori i NJAB-së. Në planin vjetor të auditimit kishte planifikuar katër¹⁸ auditime të rregullta të cilat kishte arritur t'i përfundoj. Ato kishin mbuluar fusha të ndryshme.

Komiteti i auditimit ka mbajtur tri takime konsultative dhe tri takime të rregullta, i cili me aktivitetet e tij kishte arritur të sigurojë fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 për komunën e Dragashit ka rezultuar në 18 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Komuna ka dorëzuar raportin e progresit mbi zbatimin e rekomandimeve me dt.30.09.2019 raportin e parë dhe me dt.13.03.2020 raportin e dytë sipas kërkesave të dalura nga rregullorja e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

¹⁶ Kjo shumë është prezentuar nga komuna

¹⁷ 1. Kjo shumë e detyrimeve kontraktuale përfshin: 1. Hartimi i projektit në vlerë 30,368€, 2. Mirëmbajtja e Veturave 18,420€, 3. Furnizim me dru 108,400€ dhe 4. Furnizim me pelet 2,200€, vlerë e prezantuar nga komuna e Dragashit, të cilën ne nuk kemi arritur të auditojmë.

¹⁸ 1. Prokurimi për Mallra dhe Shërbime dhe Investime Kapitale, 2. Menaxhimi i pasurisë jo financiare komunale, 3. Auditimi i të hyrave nga bashkë pagesat në shëndetësi dhe 4. Auditimi i Brendshëm i Shpenzimeve Komunale.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, shtatë rekomandime janë zbatuar, një ishte në proces të zbatimit, shtatë ishin rekomandime të mbyllura dhe tre nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar shkaqet për gjetjet e auditorit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i forcuar kontrollet në procesin e pagesave, në mënyrë që të evitohen pagesat për të cilat punët/furnizimet nuk janë kryer. Komuna duhet të emërojë një komision të veçantë për punët/furnizimet, e pa pranuar/përfunduara i cili do të monitoroj ketë proces deri në kompletimin e plotë të tyre, në të kundërtën mjetet financiare të kthehen në buxhetin komunal. Veprime specifike duhet të merren gjithashtu për të eliminuar mundësinë për prezantimin e gabimeve lidhur me shpenzimet, si dhe për të siguruar se regjistrat e pasurisë janë të plotë dhe të saktë.	Gjatë ekzaminimeve fizike në teren nuk kemi gjetur që janë bërë pagesa pa u realizuar punët.	Rekomandim i zbatuar.
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.	Çështja është mbyllur sa i përket këtij rekomandimi.	Rekomandim i mbyllur.
3	Paga dhe mëditje	Kryetari duhet të sigurojë që kompensimi i punëtorëve për punë jashtë orarit/kujdestarive të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, të mbaj evidenca të rregullta, në mënyrë që pagesa e tyre të jetë e rregullta dhe e dokumentuar. Si dhe duhet të siguroj që zyrtarët e personelit të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës së të punësuarave duke respektuar Vendimin e Qeverisë nr.06/29 të dt.15/05/2015 që përcakton rregullat dhe procedurat për dëshmimin e përvojës së punës.	Nga rastet e testuara nuk kemi gjetur parregullsi të kësaj natyre.	Rekomandim i zbatuar.
4	Paga dhe mëditje	Kryetari duhet të siguroj që janë marrë masa se dosjet elektronike janë të kompletuara, ashtu që, në përpikëri ti përmbahet rregullores për dosjet e punëtorëve.	Edhe këtë vit kemi situatë të njëjtë.	Rekomandim i mbyllur.

5	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të siguroj që kontratat e tilla të përdorën vetëm për shërbime të veçanta dhe jo për pozita të zakonshme. Ndërsa mbajtja e tatimeve në burim për personat e angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta, duhet të bëhet në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.	Nga rastet e testuara nuk kemi gjetur parregullsi të kësaj natyre.	Rekomandim i zbatuar.
6	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të siguroj se janë bërë planifikimet e duhura të komunës dhe drejtorateve/njësive përkatëse që këto shërbime të kontratohen në mënyrë që të minimizohet numri dhe vlera e blerjeve të tilla. Planifikimi më i mirë mundëson eliminimin e blerjeve ad hoc dhe siguron në shfrytëzim më efikas të buxhetit komunal për nevojat reale për mallra dhe shërbime të tilla.	Auditori nuk ka identifikua gjetje të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
7	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha zotimet e kontraktuara janë duke u realizuar në përpikëri dhe konform kushteve të parashtruara, duke eliminuar pengesën para hyrjes në marrëveshje kontraktuese. Nëse përjashtimisht paraqitet nevoja për ndërprerje të kontratës duhet të ndiqen procedurat e nevojshme sikurse është paraparë me Ligjet dhe Udhëzimet në fuqi. Gjithashtu duhet të siguroj se hartimi i projekteve ekzekutive i paraprinë inicimit të aktiviteteve të prokurimit të kontratat për punë sipas kërkesave të UA nr. 1/2014.	Auditori nuk ka gjetje për pagesat e punëve të pakryera, ndërsa ka raste kur nuk ka projekt ekzekutiv.	Rekomandim i pjesërisht i zbatuar.
8	Investime kapitale	Kryetari duhet të siguroj që bëhet një planifikim i hollësishëm dhe njësitë kërkuese duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim.	Auditori nuk ka identifikuar raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
9	Çështje e përbashkët	Kryetari duhet të siguroj që bëhet një planifikim i hollësishëm dhe njësitë kërkuese duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim	Edhe këtë vit kemi situatë të njëjtë.	Rekomandim i pazbatuar.
10	Pasurit	Kryetari të siguroj që komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare të bëjë regjistrimet dhe vlerësimin e të gjitha pasurive në posedim të komunës, dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.	Komuna ka ndërmarr veprimet e nevojshme..	Rekomandim i zbatuar.

11	Pasurit	Kryetari duhet të sigurohet se regjistri i pasurisë nën 1,000€ mirëmbahet, kontrollohet dhe të gjitha asetet e komunës mund të evidentohen sipas kriterëve të përcaktuara në rregullore.	Edhe këtë vit kemi situatë të njëjtë.	Rekomandim i pazbatuar.
12	Pasurit	Kryetari duhet të sigurohet që të gjitha pasuritë e komunës të jenë të përfshira në pasqyrat financiare të komunës në mënyrë që pasqyrat financiare të tregojnë një gjendje të saktë të pasurive të saj.	Komuna ka ndërmarr veprime e nevojshme, mirëpo çështja e ndërmarrjes shoqërore mund të ndryshoj me ndonjë aktvendim tjetër.	Rekomandim i mbyllur.
13	Paraja e gatshme	Kryetari duhet të sigurojë se depozitat e përditshme të parasë dhe kontrollet janë kryer ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.	Edhe këtë vit kemi situatë të njëjtë.	Rekomandim i pazbatuar.
14	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave për inkasimin e të hyrave të saj, përfshirë edhe të arkëtueshmet e mbetura nga vitet paraprake. Fillimisht duhen të shfrytëzohen të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të komunës, me pas të shfrytëzoj edhe masat tjera ligjore për të siguruar inkasimin e tyre.	Edhe këtë vit kemi situatë të njëjtë.	Rekomandim i pazbatuar.
15	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të përcaktoj të gjitha masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuar dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare.	Nga rastet e testuara nuk kemi hasur në raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
16	NjAB	Kryetari duhet të sigurojë se do të plotësohet me personel të mjaftueshëm NjAB, si dhe të rishikojë arsyet për veprimet e limituara të ndërmarra në lidhje me rekomandimet. Gjithashtu duhet të ndërmirën veprime shtesë për funksionalizimin e KA-të në mënyrë që të sigurojë mbikëqyrjen, ngritjen dhe fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm.	Edhe përkundër disa veprime të ndërmarra, një numër i rekomandimeve mbetet i pazbatuar.	Rekomandim i mbyllur.

17	Raportimi menaxherial	Kryetari duhet të siguroj se është hartuar politika kundër korrupsionit dhe ajo duhet të zbatohet në përpikmëri në mënyrë që të minimizohen rreziqet nga korrupsioni.	Ka përgatit listën e rreziqeve. Kjo çështje nuk do të trajtohet në raportin e vitit 2019.	Rekomandim i mbyllur.
18	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	Kjo çështje nuk trajtohet në raportin e vitit 2019.	Rekomandim i mbyllur.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	PFV	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkesat të planifikohen dhe kategorizohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e komunës, duhet të bëhet ridestিনি i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për buxhetimin e kërkesave në kategoritë përkatëse ekonomike dhe fuqizimin e kontrollit për pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejt të shpenzimeve publike në PFV.		
2	Të hyrat	Kryetari i komunës duhet të shtojë kontrollet lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale duke vlerësuar të gjitha kontrata, si dhe duke ndërmarrë masa në arkëtimin e të hyrave të pa inkasuara. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurojë së dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim bëhet sipas kërkesave të ligjit për shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.		
3	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që procesi i vlersimit të ankandëve publike bëhet nga përbërja e plotë e komisionit për vlerësimin e ofertave të pronave të paluajtshme, si dhe me të krijoj kushte që ofertuesit potencial të mos tërhiqen prej konkurrimit.		
4	Të hyrat	Kryetari duhet të vendos kontrolle duke caktuar zyrtar përgjegjës për përcjelljen e rregullave të nivelit qendror, dhe që të njëjtat të jenë të harmonizuara me rregulloret e brendshme komunale, dhe me kohë të iniciohen plotësim/ndryshimet e rregulloreve komunale duke i përcjellur për miratim tek organet relevante.		
5	Të hyrat	Kryetari të siguroj se do të zbatohen kërkesat ligjore për depozitim në llogari bankare me kohë të të hyrave të mbledhura, nëpërmes arkës nga zyrtarët kompetent.		

6	Paga dhe mëditje	Kryetari të ndërmarr veprimet e duhura në vlerësimin e situatës dhe siguroj që punësimi bëhet duke respektuar kriteret e konkursit.
7	Paga dhe mëditje	Kryetari i komunës përmes menaxherit të personelit duhet të sigurohet se stafi i drejtorisë së shëndetësisë kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës.
8	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit se aplikohet proces i plotë i procedurave të prokurimit në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi duke ndërmarr veprimet e nevojshme, tërheqjen e sigurisë së tenderit për ofertuesit jo serioz.
9	Subvencione dhe transfere	Kryetari duhet të siguroj që më rastin e shpalljes/thirrjes publike të vendosen kriteret dhe që më rastin e përzgjedhjes së përfitueseve të subvencioneve të shpërblehen vetëm ata të cilët i kanë plotësuar të gjitha kërkesat.
10	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet para inicimit të procedurave të prokurimit.
11	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që në procedura të prokurimit, kriteret të vendosen sipas kërkesave ligjore duke vërtetuar përshtatshmërinë e operatorëve ekonomik.
12	Investime kapitale	Kryetari i Komunës duhet të sigurohet që të ndalohet praktika e ndërprerjes së kontratave pa përfillë procedurat dhe kriteret ligjore. Gjithashtu duhet siguar nivelin e duhur të komunikimit mes departamenteve me qëllim të përmbushjes së objektivave të komunës krahas respektimit të ligjeve.
13	Çështje të përbashkëta	Kryetari duhet të siguroj që bëhet një planifikim i hollësishëm dhe njësitë kërkuese duhet të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim.
14	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Kryetari duhet të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullores 02/2013 dhe kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, përmes sistemit e-pasuria të evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajshme (me vlera nën 1,000€) për të gjitha dikasteret komunale.
15	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragash
02 Nr. Br. 400/01-13401/20
07.08 20 20
Dragash - Dragash



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së **Dragashit**, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Shaban Shabani

Kryetar i Komunës së Dragashit

Data: 07.08.2020, Dragash